

Gati, vondsos, apliko!



*Përgatitja për strehim të
përballeshëm në qytetin
e Nju-Jorkut*



NYC

Housing Preservation
& Development

Consumer
Affairs

1

Mësoni rreth
mundësive për strehim
të përballueshëm f. 3

2

Përgatituni për
të aplikuar f. 5

3

Aplikoni f. 8

4

Përgatituni në rast
interviste f. 12

5

Burimet f. 16

Mësoni rreth mundësive për strehim të përballueshëm



Përgatitja për të aplikuar për strehim të përballueshëm
kërkon kohë dhe është më shumë sesa thjesht plotësimin e
shkresave. Ky udhëzues do t'ju ndihmojë të organizoheni
për të bërë një aplikim të mirë.

Çfarë është strehimi i përballeshëm?

Strehimi zakonisht konsiderohet **i përballeshëm** nëse kushton sa rreth një e treta ose më pak e te ardhurave së jetesës së njerëzve që jetojnë aty. Për familjet me të ardhura të ndryshme ofrohen lloje të ndryshme strehimi të përballeshëm.

Në këtë udhëzues, me "strehim të përballeshëm" kuptojmë apartamentet që janë pjesë e programeve shtetërore të strehimit të përballeshëm. Ai fokusohet në strehimin e subvencionuar nga Departamenti i Ruajtjes dhe Zhvillimit të Strehimit (HPD) dhe nga Korporata e Zhvillimit të Strehimit (HDC) të qytetit të Nju-Jorkut.

Informacioni në këtë udhëzues do t'ju ndihmojë të përmirësoni aplikimin për shumë lloje të ndryshme programesh strehimi të përballeshëm—si dhe për strehim në tregun privat.



Kush kualifikohet për strehim të përballeshëm? Të gjithë mund të aplikojnë! Por:

- Duhet të jeni minimalisht 18 vjeç.
- Ndoshta do t'ju duhet një numër sigurimesh shoqërore (SSN) ose numri unik i identifikimit të subjektit (ITIN).
- "HPD" dhe "HDC" u japin zakonisht përparësi strehimi banorëve të qytetit të Nju-Jorkut.
- Të ardhurat tuaja duhet të jenë brenda një diapazoni të caktuar, i cili ndryshon në varësi të numrit të personave që jetojnë me ju dhe përcaktohet nga secili prej programeve të strehimit.

Përgatituni për të aplikuar



Aplikimin mund ta përmirësoni me disa hapa të rëndësishëm. Por mund të duhen disa muaj për kryerjen e këtyre hapave—ndaj, filloni sot!



Njihuni me historikun tuaj të shlyerjes së kredive


Qiradhënësit nuk mund t'ju shkualifikojnë duke u bazuar vetëm në vlerësimin e aftësisë kreditore, por mund t'ju kontrollojnë historikun e shlyerjes së kredive. Sigurohuni që informacioni në raportin e kredimarrësit të jetë i saktë dhe, nëse është e nevojshme, merrni masa për të përmirësuar vlerësimin e aftësisë kreditore.

- Merrni falas raportin e kredimarrësit në annualcreditreport.com
- Pasaktësitë në raportin e kredimarrësit mund t'i korrigjoni duke paraqitur një kërkesë në internet, me telefon ose duke i dërguar një letër shoqërisë së raportimit kreditor.
- Kërkoni ndihmë për të kuptuar raportin e kredimarrësit dhe mësoni si të përmirësoni vlerësimin tuaj të aftësisë kreditore me ndihmën pa pagesë të një konsulenti financiar profesionist. Për më shumë informacion, vizitoni nyc.gov/consumers ose telefononi numrin 311 dhe kërkoni të lini një takim në një nga qendrat e konsolidimit financiar të qytetit të Nju-Jorkut.

Njihuni me historikun tuaj në Gjykatën e Çështjeve të Strehimit

Qiradhënësit mund të verifikojnë nëse jeni thirrur nga Gjykata e Çështjeve të Strehimit apo nëse jeni dëbuar nga banesa. Kontrolloni paraprakisht historikun tuaj që të mund të trajtoni problemet dhe të jeni gati t'u përgjigjeni pyetjeve që mund të lindin.


- Gjeni dhe printoni një kopje të historikut tuaj në kompjuterët publikë të disponueshëm në ambientet e Gjykatës së Çështjeve të Strehimit. Vizitoni nycourts.gov/courts/nyc/housing për ambientet e kësaj gjykate dhe për më shumë informacion.
- Sqaroni vendimet në disfavorin tuaj duke kërkuar ndihmë nga një avokat i Gjykatës së Çështjeve të Strehimit ose vizitoni nycourts.gov për informacion mbi marrjen e ndihmës ligjore.



Filloni të kurseni

Duhet të kurseni të paktën qiranë e dy muajve për të mbuluar muajin e parë dhe depozitën e garancisë. Mund t'ju duhet të kurseni edhe më shumë për të mbuluar shpenzimet e shpërnguljes.

- Filloni të kurseni për shpërnguljen duke gjetur një llogari kursimi që përfiton interes nga një bankë ose shoqatë kredish.
 - ✓ Nëse keni kartë "IDNYC", mund ta përdorni për të hapur një llogari në shumë banka dhe shoqata kredish. Vizitoni: on.nyc.gov/idnycbanks për të zbuluar vendndodhjet.
 - ✓ Për ndihmë lidhur me krijimin e një buxheti, kursimin ose hapjen e një llogarie bankare, vizitoni një qendër konsolidimi financiar të qytetit të Nju-Jorkut. Për informacion, vizitoni nyc.gov/consumers ose telefononi numrin 311 dhe kërkoni të lini një takim në një nga qendrat e konsolidimit financiar të qytetit të Nju-Jorkut.



2x

Aplikoni



Pasi të keni filluar të merreni me kreditë, historikun në Gjykatën e Çështjeve të Strehimit dhe kursimet, filloni aplikimin për strehim të përbalueshëm!


Krijoni profilin tuaj në "Housing Connect"

Hapi i parë në aplikimin për strehim të përbalueshëm është krijimi i një profili në "Housing Connect" në adresën: nyc.gov/housingconnect

- Do t'ju nevojitet informacion rreth të ardhurave të çdo personi që do të jetojë në apartament.



Të ardhurat



★ Të ardhurat përfshijnë paratë që merrni nga një punë e rregullt, nga biznesi privat dhe/ose nga puna me kohë të pjesshme. Ato përfshijnë edhe para të tjera që merrni nga kompensimi i punonjësve, nga shteti (si sigurimet shoqërore ose ndihma shtetërore) dhe pagesa të caktuara nga investimet dhe dalja në pension.

Shumicën e këtij informacioni e gjeni në deklaratën tatimore të paraqitur vitin e kaluar.

Nëse punoni për një person tjetër, përfshini shumën që ju paguhet pa përfshirë tatimet (e quajtur "të ardhurat bruto"). Nëse jeni i vetëpunësuar, përfshini shumën që fitoni pas tatimeve dhe zbritjeve të tjera (e quajtur "të ardhurat neto").


Nëse ju nevojitet më shumë ndihmë për të kuptuar se çfarë llogariten si të ardhura, kontrolloni udhëzuesin e të ardhurave që "HPD" ka vënë në dispozicion për aplikantët për strehim të përbalueshëm: nyc.gov/hpd/incomeguide

Kërkoni për apartamente

- Përdorni faqen "Kërkim" në "Housing Connect" për të gjetur lista strehimi të përballeshëm. Klikoni emrin për të mësuar nëse kualifikoheni për një lotari banesash.

★ Quhet "lotari" sepse funksionon si e tillë: të gjitha aplikimet grumbullohen dhe përzgjidhen rastësisht.

- Listat mund t'i gjeni edhe në gazeta dhe në faqet e internetit të "HPD" dhe "HDC": nyc.gov/hpd dhe nychdc.com
- Në çdo listë do të jepet numri i apartamenteve në dispozicion, numri i personave që mund të jetojnë në secilin apartament, diapazoni i të ardhurave familjare që duhet të keni për t'u kualifikuar dhe afati i aplikimit.



- Nëse të ardhurat tuaja familjare janë shumë të larta ose shumë të ulëta për atë banesë, nuk do të kualifikoheni. Aplikoni në lotari për banesa që janë të përshtatshme për numrin e personave që jetojnë me ju dhe që përputhen me diapazonin e të ardhurave që fiton secili.
- Disa apartamente janë të rezervuara për persona në situata specifike, duke përfshirë nëse ju:
 - ✓ keni aftësi të kufizuara në lëvizje, dëgjim apo shikim
 - ✓ jetoni në të njëjtin distrikt komuniteti
 - ✓ punoni për qytetin

Nëse ndonjë nga rastet e mësipërme vlen për ju, sigurohuni që ta përfshini në profilin tuaj dhe në aplikimet në lotari.

- Mbajeni të përditësuar profilin tuaj në "Housing Connect". Për shembull, nëse filloni një punë tjetër ose nëse e humbi punën, sigurohuni ta përditësoni këtë informacion. Kontrolloni profilin tuaj sa herë që aplikoni për një ndërtesë tjetër.

Aplikoni!

Nëse gjeni një ndërtesë për të cilën kualifikoheni, klikoni "Aplikoni" përmbri rezultatit për të filluar aplikimin.

- Gjithashtu, mund të plotësoni një fletë aplikimi dhe ta dërgoni me postë.
 - ✓ Çdo listë do të ketë informacion për mënyrën e marrjes së një flete aplikimi.
 - ✓ Në aplikim do të ketë informacion që do t'ju tregojë adresën e postimit.
 - ✓ Marrja e letrës së aplikimit me postë mund të zgjasë disa ditë, kështu që nëse po afron afati, merrni në konsideratë aplikimin në internet. Në lotari, aplikimet me shkrim dhe në internet trajtohen në të njëjtën mënyrë.

- Aplikoni para përfundimit të afatit! Periudha e aplikimit mund të zgjasë nga disa javë deri në disa muaj, prandaj lëri vetes kohë të mjaftueshme.


- Nëse aplikoni para përfundimit të afatit, nuk ka rëndësi se kur e dorëzoni aplikimin.

- Aplikimet e dyfishta mund të shkualifikohen, prandaj mos dërgoni më shumë se një aplikim. Dërgoni vetëm një prej aplikimeve: atë me shkrim ose atë në internet.

Pas aplikimit

Mund të kalojë një vit ose më shumë derisa të njoftoheni për aplikimin. (Ndonjëherë mund të mos njoftoheni.)

- Gjatë kohës që prisni, kontrolloni me kujdes se çfarë thuhet në kontratën tuaj të qirasë për largimin para përfundimit të periudhës së përcaktuar. Nëse ju ofrohet një apartament, mund t'ju duhet të shpërnguleni brenda një kohe të shkurtër.
- Fakti që kualifikoheni nuk do të thotë që aplikimi juaj do të zgjidhet në lotari.
- Nëse nuk përzgjidheni ose nëse nuk njoftoheni, vazhdoni të kërkoni për apartamente të tjera dhe aplikoni kur të jeni gati.



Përgatituni në rast interviste



Nëse aplikimi juaj zgjidhet, do t'ju ftojë për intervistë verifikimi me agjentët e banesës. Kjo intervistë është shumë e rëndësishme.


Agjentët e banesës do të konfirmojnë nëse kualifikoheni për apartamentin për të cilin keni aplikuar. Përgatituni në kohë për t'u siguruar që jeni të përgatitur.

Mblidhni dokumentet e rëndësishme

Në intervistë, do t'ju duhet të paraqisni dokumente që vërtetojnë informacionin që keni përfshirë në aplikim. Filloni t'i mblidhni kopjet e tyre që sot!

Duhet të tregoni se:

- Me kë do të jetoni.
Shembuj:
 - certifikatat e lindjes
 - kartat e sigurimeve shoqërore
 - letërnjoftimet me fotografi
- Të ardhurat e çdo personi që do të jetojë me ju.
Shembuj:
 - çeqet e pagave
 - deklarimi i tatimeve shtetërore ose federale
 - vërtetim i sigurimeve shoqërore, përfitimeve nga statusi i veteranit ose nga ndihma shtetërore
- Informacion rreth apartamentit tuaj aktual.
Shembuj:
 - kontrata aktuale e qirasë
 - faturat për qiranë
 - fatura të fundit të gazit ose energjisë elektrike
- Nëse ju nevojitet ndihmë për të marrë kopjet e këtyre dokumenteve, vizitoni faqen e internetit të "HPD": [nyc.gov/hpd/afteryouapply](https://www.nyc.gov/hpd/afteryouapply)



Përgatituni për intervistën e verifikimit

Do të merrni një letër ose email me udhëzimet për mënyrën e planifikimit të intervistës së verifikimit. Çdo person 18 vjeç e lart që do të jetojë në apartament duhet të paraqitet në intervistë.

- Për të planifikuar intervistën tuaj, kontaktoni agjentin e ndërtesës të listuar në letër.
- Riplanifikoni intervistën, nëse është e nevojshme, duke telefonuar sa më shpejt të jetë e mundur numrin e shënuar në letër. Shumica e agjentëve kërkojnë njoftim minimalisht 24 orë përpara.
- Agjenti do t'ju informojë për formularët që duhet të sillni. Nëse keni pyetje, telefononi numrin e renditur në letrën tuaj.



Pas intervistës së verifikimit...

Mund t'ju duhet të ndiqni disa hapa të mëtejshëm për t'u siguruar që aplikimi ka përfunduar. Pas kësaj...

- Aplikimi juaj mund të pranohet. Duhet të kaloni disa hapa të tjerë para se të vendosni nëse dëshironi të nënshkruani një kontratë qiraje.
- Mund të vendoseni në listë pritjeje, e cila mund të zgjasë deri në dy vjet. Agjenti mund t'ju kontaktojë për të përditësuar të dhënat tuaja. Kontaktojeni nëse nuk doni të jeni më në listë.
- Mund të merrni një letër refuzimi që ju njofton se nuk kualifikoheni dhe arsyen përkatëse. Në këtë rast, keni të drejtën e apelimit. Kjo do të thotë se do të keni mundësinë të shpjegoni pse mendoni se vendimi nuk ishte i duhur.
 - ✓ Nëse doni të apeloni, veproni menjëherë—keni vetëm 10 ditë pune kohë nga data e dërgimit të letrës për të paraqitur ankesën!
 - ✓ Dërgojini një letër agjentit të banesës, në të cilën shpjegoni arsyen pse mendoni se nuk duhet të ishit refuzuar. Përfshini çdo dokument që mbështet apelimin tuaj. Adresën e dërgimit e gjeni në letrën e refuzimit.



- ✓ Agjentët e banesës do të shqyrtojnë kërkesën tuaj dhe do t'ju dërgojnë një letër përgjigjeje.
 - ✓ Nëse apelimi rezulton i suksesshëm, do të merrni një letër miratimi ose do të vendoseni në listën e pritjes.
 - ✓ Në të kundërt, do të merrni një letër refuzimi. Nëse mendoni se ka ende një gabim, mund të kontaktoni agjencinë ("HPD" ose "HDC") për t'i paraqitur ankesë brenda pesë ditësh pune. Sigurohuni që të përfshini një shpjegim të arsyes pse mendoni se ka një gabim. Në letër do të gjeni agjencinë që duhet të kontaktoni dhe mënyrën e kontaktit.
- Nëse jeni në listë pritjeje ose merrni një letër refuzimi, aplikimet që ua keni dërguar banesave të tjera janë ende të vlefshme. Vazhdoni të përgatiteni në rast se përzgjidheni për një banesë tjetër!



Burimet

Z

B

U

L

O

M

E

GJENI DHE APLIKONI PËR STREHIM TË PËRBALLUESHËM

nyc.gov/housingconnect

GJENI MUNDËSI TË TJERA STREHIMI
TË SUBVENCIONUARA NGA QYTETI

Faqja e internetit e "HPD":
nyc.gov/hpd/rentalopportunities

Faqja e internetit të "HDC":
nychdc.com/pages/Now-Renting.html

KËRKONI NDIHMË PËR TË GJETUR DHE APLIKUAR
PËR STREHIM TË PËRBALLUESHËM

nyc.gov/hpd/findhousing

MUND TË KËRKONI NDIHMË EDHE NGA
NJË PËRFAQËSUES STREHIMI

Këto janë organizata komunitare.
Gjeni një të tillë në:
nyc.gov/hpd/findhousingresources

PËRGATITUNI TË APLIKONI PËR STREHIM TË PËRBALLUESHËM
ME KONSULENCË FINANCIARE PROFESIONALE DHE
INDIVIDUALE, PA PAGESË, NË NJË NGA QENDRAT E
KONSOLIDIMIT FINANCIAR TË QYTETIT TË NJU-JORKUT

Vizitoni nyc.gov/consumers për më shumë
informacion ose telefononi numrin 311 për të
lënë një takim në një nga qendrat e konsolidimit
financiar të qytetit të Nju-Jorkut.

Ky projekt u realizua në bashkëpunim me Qendrën për Pedagogji Urbane (CUP),
një organizatë jofitimprurëse që përdor fuqinë e projektimit dhe artit për të rritur
pjesëmarrjen e konsiderueshme të qytetarëve: welcometoCUP.org
Disenjuar nga "Maison Papercut": maisonpapercut.com · Ilustrimet nga Rebecca Clarke.

S

H

U

M

Ë



Housing Preservation
& Development

Consumer
Affairs



Citi Foundation
citi

